

**AKTI I THEMELIMIT  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
SWAn Corp.**

**Neni 1 - Emri**

1.1 Shoqëria krijohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është SWAn Corp. Shpk, më poshtë do të quhet "Shoqëria".

**Neni 2 - Themelimi**

2.1 Shoqëria themelohet sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe fiton personalitet juridik me regjistrimin në Regjistrin Tregtare Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

2.2 Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin Shqiptar, me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

**Neni 3 - Selia**

3.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Milan Shuflaj, Pallati 8, Apartamenti 20, Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Shqipërisë.

**Neni 4 - Ortaku i Vetëm**

4.1 Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:

- Z. Andi Koçiaj, shtetas shqiptar, lindur në Fier, më 25.02.1990, mbajtës i leternjoftimit nr. 037081679, me adresë në: Rruga Milan Shuflaj, Pallati 8, Apartamenti 20, Tiranë.

**Neni 5 - Kapitali Themeltar**

5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) Lekë. Pra, kapitali i Shoqërisë është 100 lekë, i ndarë në një kuotë me vlerë prej 100 (njëqind) lekë, që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë.

5.2 Kuotat, me vendim të Ortakut të Vetëm, janë lirisht të transferueshme tek çdo individ ose person juridik nëpërmjet kontratës së shitblerjes, trashëgimisë, dhurimit ose nëpërmjet çdo mënyre tjetër të parashikuar nga ligji.

**Neni 6 - Objekti**

6.1 Objekti i Shoqërisë është: Shërbime analize, marketing dhe mirëmbajtje të dhënash për Agjencitë e Siguracionit.

6.2 Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi, i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm.

**Neni 7 - Kohëzgjatja**

7.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar Shqiptar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**Neni 8 - Kompetencat e Ortakut të Vetëm**

8.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me ligjet shqiptare, mund të marrë, por pa u kufizuar vetëm në to, vendime për ndryshimin e Statutit, bashkimin me shoqëri të tjera, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, transferimin e plotë ose të pjesshëm të kuotave, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, emërimin e ekspertit kontabël, miratimin e llogarive vjetore dhe të pasqyrave financiare, likuidimin e Shoqërisë, emërimin e likuidatorit.



8.2 Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetëm do të regjistrohen sipas rendit kronologjik në Regjistrin e Vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose fshihen. Vendimet e paregjistruara në këtë regjistër janë të pavlefshme. Administratori/ët e Shoqërisë janë përgjegjës për mbajtjen e Regjistrit të Vendimeve.

#### **Neni 9 - Administrimi i Shoqërisë**

9.1 Administratorët e parë të Shoqërisë janë:

a. Z. Andi Koçiaj, shtetas shqiptar, lindur në Fier më 25.02.1990, mbajtës i letërnjoftimit nr. 037081679, me adresë në: Rruga Milan Shuflaj, Pallati 8, Apartamenti 20, Tiranë.

9.2 Administratorët emërohet me vendim të Ortakut të Vetëm dhe do të qëndrojnë në detyrë për një afat 5 vjeçar. Administratorët mund të rizgjidhen për të njëjtin afat në bazë të vendimit të Ortakut të Vetëm ose në përputhje me dispozitat ligjore.

#### **Neni 10 - Ligji i Zbatueshëm**

10.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me ligjin shqiptar.

10.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë gjatë aktivitetit të Shoqërisë, do të zgjidhet me mirëkuptim, në rast të kundërt mosmarrëveshja do të jetë objekt i zgjidhjes pranë Gjykatës kompetente të Rrethit Gjyqësor.

10.3 Ky Akt Themelimi është hartuar në dy ekzemplarë në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila.

Nënshkruar nga Ortakut i Vetëm sot më datë 02 Prill 2021.

Z. Andi KOÇIAJ

ANDI KOÇIAJ